



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 14 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 1821 prot., datë 26.03.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Lidhur me kërkesën tuaj për vënie në dispozicion të jetëshkrimit të ish-gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ju bëjmë me dije se, bazuar në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 3 “Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi të plotë organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të caktuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj”, sqarojmë se lidhur me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk disponon dokumentacion lidhur me dosjet personale.

Ndërsa referuar kërkesës lidhur me jetëshkrimin e ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ju bëjmë me dije se, bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, neni 1 “Këshilli i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën, dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit” Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka ushtruar kompetencat në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, duke mos pasur juridiksion rreth Gjykatës së Lartë.

Në këto kushte, nga institucioni i Këshillit të Lartë të Drejtësisë që u trashëgua nuk rezultojnë të administruara dosjet personale të ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të cilët janë larguar nga sistemi referuar vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit në vitin 2019.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!